



PROUD ROMA TALENT

KONKURSI I TALENTIT ROM NGA ERIAC 2022

SHTYHET AFATI PER APLIKIM: 29 NENTOR

A je një Rom/e Krenar/e? Na trego talentin tënd!

Instituti European Rom për Artin dhe Kulturën – ERIAC po nis konkursin më të ri online të talentit – PROUD ROMA TALENT – për të festuar kulturën, identitetin dhe trashëgiminë Rome. Këtë vit, ne mirëpresim aplikime në zhanrin muzikë, kërcim dhe performanca të tjera artistike për ti treguar botës se identiteti Rom është i larmishëm dhe i pasur!

Të gjithë personat e vetëdeklaruar Romë në Europë kanë të drejtë të aplikojnë dhe të konkurojnë për të fituar deri në 3,000 euro!

Çmimet:

Vendi i parë: 3.000 EUR

Vendi i dytë: 2.000 EUR

Vendi i tretë: 1.500 EUR

++Konkurentet nga Serbia, Hungaria dhe Kosova¹ gjithashtu kanë shansin të fitojnë një nga tre çmimet speciale ne nivel lokal prej 1000 EUR të ndara nga partnerët tanë Opre Roma Srbija, 1Hungary Initiative / Roma Sam dhe OPRE ROMA Kosovo.

+++ Aplikantet që dorëzojnë videot e tyre nëpërmjet TikTok me hashtagun #proudromatalent kanë gjithashtu shansin të fitojnë çmimin **TikTok Audience** prej 500 EUR.

Trego krenarinë tënde! Shpalos talentin tënd. [APLIKO TANI!](#)

¹ Të gjitha referencat për Kosovën, në lidhje me territorin, institucionet apo popullsinë, të paraqitura në këtë dokument, do të interpretohen në përputhshmëri të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe pa paragjykim mbi statusin e Kosovës.

Kush mund të marrë pjesë në konkurs?

Performues profesionistë ose amatorë nga e gjithë Europa që i përkasin minoritetit Rom.
Performancat mund të jenë individuale ose në grup.

Cilat talente pranohen në konkurs?

Të gjitha talentet do të pranohen në **TRE KATEGORI: MUZIKË, KËRCIM** dhe zhanre të tjera **PERFORMUESE** duke përfshirë akrobatikë, disiplinat e cirkut, truke magjike, recitim, poezi interaktive, etj.

Si mund të marr pjesë?

Ngarko videon tënde duke plotësuar [formularin online të aplikimit](#) deri në datën **29 Nëntor 2022, 23:59 CET**.

Si do të përzgjidhen fituesit?

Të gjitha videot e ngarkuara nga konkurentët do të shpërndahen nga ekipi i ERIAC në faqen zyrtare të ERIAC në Facebook brënda 48 orëve nga data e ngarkimit të videos. Videot e postuara do të fitojnë shikueshmëri publike deri në datën **4 Dhjetor, 2022**.

21 videot më të shikuara (7 për kategori) në faqen e ERIAC në Facebook do të vlerësohen nga një juri ndërkombëtare e cila do të zgjedhë **fituesit e vendeve të 1, 2 dhe 3**.

++ 10 videot më të shikuara në rang kombëtar nga Serbia, Hungaria dhe Kosova do të jenë kandidatë për të fituar një nga **Çmimet Speciale**. Një Çmim Special do të jepet për çdo vend nga organizatat lokale Rome *Opre Roma Srbija* në Serbi, *1Hungary Initiative / Roma Sam* në Hungari dhe *OPRE ROMA Kosovo* në Kosovë. [Fituesit e vendit 1, 2 dhe 3 në rang Europian nuk mund të përfitojnë një nga Çmimet Speciale.]

+++ Konkurentët që ngarkojnë videot e tyre nëpërmjet TikTok (publikojnë videot e tyre në TikTok me hashtag #proudromatalent dhe dërgojnë linkun e videos në formularin e aplikimit) do të kenë gjithashtu shansin të konkurrojnë për **Çmimin e Audiencës TikTok**. Videoja më e pëlqyer në TikTok do të fitojë 500 EUR.

Cilat janë rregullat?

Ju lutemi të lexoni me kujdes rregullat. **Aplikimet që nuk respektojnë rregullat nuk do të pranohen.**

- Videot duhet të jenë minimalisht 45 sekonda dhe maksimumi 2 minuta;
- Konkurentët mund të performojnë vetëm ose në grup;

- Çdo konkurent/grup mund të aplikojë vetëm një herë (dmth. shfaqet në 1 video); nëse videoja është e përshtatshme për kategori të ndryshme, konkurenti duhet të zgjedhë 1 kategori.
- Videoja mund të regjistrohet me një kamera ose telefon. Cilësia e videos nuk ndikon në vendimin e jurisë.
- Videot që përfshijnë muzikë me të drejtë autori pranohen, por muzika mund të çaktivizohet automatikisht në momentin që videoja do të ngarkohet në Facebook. Juria do të shqyrtojë videon origjinale të ngarkuar në formularin e aplikimit.
- Videot e dorëzuara në ditët e fundit të periudhës së dorëzimit mund të publikohen pas afatit të dorëzimit. Ato do të kenë **5 ditë shtesë (deri më 4 Dhjetor 2022)** për t'u shpërndarë dhe për të fituar shikime!
- Formulari i aplikimit duhet të plotësohet në anglisht. Një kopje informuese e formularit të përkthyer në shqip ndodhet në fund të këtij dokumenti.
- **Sa më herët të ngarkoni videon tuaj, aq më të mëdha janë shanset për të fituar më shumë shikime!**
- Duke marrë pjesë në konkursin online, pjesëmarrësit lejojnë ERIAC të ruajë të dhënat e tyre të kontaktit për të ofruar informacione ose mundësi të mëtejshme. ERIAC nuk do t'ua kalojë të dhënat e pjesëmarrësve palëve të treta.
- Videoja duhet të jetë rregjistruar gjatë muajit të fundit (jo më herët se Tetor 2022)
- Videoja nuk duhet të ketë përmbajtje të përshtatshme apo përmbajtje që shkel të drejtat e palëve të treta

Cilat janë datat e konkursit?

Videot mund të ngarkohen nëpërmjet formularit online të aplikimit duke filluar që nga data **26 Tetor 2022 deri në datën 29 Nëntor 2022, 23:59 CET**. Videot e ngarkuara pas datës 22 Nëntor nuk do të pranohen.

Fituesit e konkursit do të publikohen në datën **9 Dhjetor 2022** në faqen e ERIAC në Facebook si dhe në websiten e ERIAC.

Kush është juria?

Anëtarët e jurisë do të publikohen në Nëntor 2022.

E RËNDËSISHME. Informacioni i mëposhtëm ka për qëllim vetëm t'ju udhëzojë në plotësimin e formularit të aplikimit. Për të hyrë në konkurs, ju lutemi dorëzoni aplikacionin tuaj nëpërmjet formularit zyrtar të aplikimit në gjuhën angleze [këtu](#).

PROUD ROMA TALENT – Formulari i aplikimit për Konkursin Online të Talentit 2022

(*) nënkupton fusha të detyrueshme

INFORMACION PERSONAL

Emri i plotë*

Emri

Mbiemri

Emri personal i individit që po aplikon në emër të grupit apo si artist solo.

A e identifikon veten si Rom? *

Termi Rom përfshin një grup divers komunitetesh duke përfshirë Roma, Sintj, Kale, Romanichal, Boyash/Rudari, Ashkali, Egjiptianë, Yenish, Dom, Lom, Abdal, si dhe grupet Nomade (Gens du voyage, Ciganet, Camminate, etj)

Po

Jo

A je anëtar i ERIAC?*

Po

Jo

Email*

Numri i telefonit*

Ju lutem vendosni prefiksin ndërkombëtar (P.sh: +381, +36, +383 etj.)

Shteti*

Ju lutem vendosni shtetin ku jeni rezident. PROUD ROMA TALENT është i hapur për të gjithë rezidentët e vendeve të Këshillit të Europës si dhe Kosovës.

RRETH VIDEOS

Çfarë përmban videoja juaj?*

Ju lutem zgjidhni një kategori e cila përfaqëson më së miri videon tuaj.

MUZIKE

KERCIM

PERFORMANCE

Emri Artistik

Emri artistik ose emri i grupit, të cilin do donit të titullohej videoja juaj në publikimet e ERIAC. Ju lutem lëreni bosh nëse doni të përdorni emrin tuaj personal të vendosur më sipër.

Sa persona performojnë në videon tuaj?

Ju lutemi lëreni bosh nëse jeni performues solo.

NGARKIMI I VIDEOS

Ju mund të ngarkoni videon tuaj në një nga 3 mënyrat e mëposhtme. **Ju lutem zgjidhni vetëm 1 opsion.**

Vendos linkun e videos nga TikTok

Bëhu pjesë e shansit për të fituar Çmimin e Audiences TikTok! Publiko videon tënde në TikTok me hashtagun #proudromatalent dhe vendos linkun e videos këtu.

Vendos linkun e videos nga platforma të tjera

Vendos linkun e videos të ngarkuar në platforma të tjera (p.sh, WeTransfer, MyAirBridge, Tresorit, etj)

Ngarko videon këtu

Ju mundeni të ngarkoni videon tuaj në këtë formular aplikimi.

Madhësia maksimale e videos: 512 MB

Vetëdeklarim rreth videos së ngarkuar*

Unë konfirmoj se videoja ime është rregjistruar gjatë muajit të fundit (jo më herët se Tetor 2022) dhe se është në përputhshmëri me rregullat e parashtruara në thirrjen zyrtare të këtij konkursi.

Autorizim*

Duke dorëzuar këtë video, unë pranoj që videoja ime të përdoret, modifikohet dhe shpërndahet nga ERIAC për qëllime që lidhen me konkursin PROUD ROMA TALENT dhe për qëllime promovuese gjatë dhe pas ngjarjes.

Duke marrë pjesë në këtë konkursin, unë pranoj që ERIAC të ruajë dhe përdorë të dhënat e mia personale për të ofruar informacione ose mundësi të mëtejshme. ERIAC nuk do t'ua kalojë të dhënat e pjesëmarrësve palëve të treta.

Do të doja të regjistrohesha në buletin e ERIAC.